




USAID
 NGA POPULLI AMERIKAN
 OD AMERIČKOG NARODA

BYRN
 BALKAN
 INVESTIGATIVE
 REPORTING
 NETWORK | KOSOVO

FOL

Ankesat Disiplinore ndaj Gjyqtarëve



Janar, 2020



Titulli: Raport mbi Monitorimin e Ankesave ndaj Gjyqtarëve

Autor: Labinot Leposhtica

Ndihmuan: Marcel Lekaj, Blerta Iberdemaj, Vyrtyte Gervalla, Kastriot Berisha, Erolinda Uka, Fitim Limani, Ermonda Zogiani, Adelina Idrizi, Bahrie Sadiku, Tringa Rruka


Dizajni: Granit Mavriqi, Krenar Ferizi

Lektoruar: Perparim Isufi

Viti i botimit: Janar 2020

Publikuar nga: BIRN Kosova
Rr. Rr. Afrim Zhitia Nr.7,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Të drejtat e autorit © 2020. BIRN Kosova. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.




Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë i USAID është një aktivitet pesëvjeçar i sundimit të ligjit në Kosovë si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme të USAID për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe të sigurojë që sistemi i drejtësisë operon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi fokusohet në promovimin e sistemit të drejtësisë bazuar në standardet më të larta të pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe në mbështetje të funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në komunat në veri. Fuqizimi i efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e gjyqësorit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore. Përmes USAID, Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat në konsolidimin e rezultateve, në efektshmërinë dhe menaxhimin e tyre.

BIRN Kosova është organizatë e pavarur joqeveritare, qëllimi kryesor i së cilës është të kontribuojë për një proces të suksesshëm demokratik, përfshirë reformat në sistemin e drejtësisë. Për ta bërë këtë, BIRN krijoi një platformë të njohur online anti-korrupsion, prodhoi dhe transmetoi debate televizive, hulumtimi nga terreni dhe raporte me ndikim analitik.



Ky raport është realizuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e BIRN Kosova dhe jo domosdoshmërisht reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.






Përmbajtja

Akronimet	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	7
Metodologjia e realizimit të monitorimit	8
Të dhëna të përgjithshme tabelore për rastet disiplinore	9
Shqyrtim individual i rasteve sipas gjykatave	10
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	10
Gjykata Supreme	10
Gjykata e Apelit	11
Gjykata Themelore në Prishtinë	12
Gjykata Themelore në Mitrovicë	15
Gjykata Themelore në Pejë	15
Gjykata Themelore në Prizren	16
Gjykata Themelore në Ferizaj	17
Gjykata Themelore në Gjiilan	17
Gjykata Themelore në Gjakovë	19
Institucioni i Avokatit të Popullit	20
Ligji i ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve	22
Mangësitë e Ligjit	22
Shkelja e konfidencialitetit të procedurës	23
Rekomandimet	24
Referencat	25

Akronimet

BIRN	Balkan Investigative Reporting Network
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
JSSP	Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
LPDGJ	Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar





Përmbledhje Ekzekutive

Ky monitorim realizohet në kuadër të Projektit të BIRN dhe FOL mbështetur nga Programi i USAID për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP). Monitorimi ka për qëllim të vlerësojë efikasitetin në trajtimin e ankesave disiplinore të iniciuara ndaj gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në Republikën e Kosovës përgjatë periudhës 4 mujore, 1 korrik deri më 1 nëntor 2019. Përmes këtij raporti, synohet të pasqyrohet numri i ankesave të pranuar nga Autoriteti Kompetent, numri i rasteve të refuzuara dhe të hedhura, numri i rasteve të referuara në Prokurorinë e Shtetit dhe numri i rasteve për të cilat është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Gjetjet kryesore të raportit tregojnë që:

- Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve ka lënë pa adresë palët që duan të ankohen ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Respektimi i afateve në trajtimin e rasteve disiplinore duke filluar nga Autoriteti Kompetent dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Moskrijimi i regjistrave elektronikë nga KGJK për rastet disiplinore dhe rritja e transparencës në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve;
- Vonesa dhe mangësi në trajtimin e rasteve disiplinore, duke filluar nga mosnjoftimi i Këshillit Gjyqësor për pranimin e ankesave disiplinore;
- Mosrespektimi i periudhës për shqyrtimin e ankesave disiplinore nga Autoriteti Kompetent;
- Dështimi për të njoftuar në kohë Institucionin e Avokatit të Popullit dhe palën që ka parashtruar ankesën;
- Mosrespektimi i parimit të fshehtësisë së procedurës nga ana e KGJK-së për moszbulimin identitetit të gjyqtarëve që janë subjekt i procedurës disiplinore qysh në fazën e formimit të panelit hetimor.

Në përgjithësi, nga 1 korriku deri më 1 nëntor 2019, të gjitha gjykatat e Kosovës (që kanë ofruar përgjigje), gjatë vitit kanë pranuar 34 raste të ankesave, prej të cilave në 19 raste apo 56% të tyre janë refuzuar ankesat, në 5 raste apo 14% është kërkuar iniciimi i hetimeve, 5 raste janë në proces dhe për 5 raste të tjera nuk ka informacion në lidhje me mënyrën e vendosjes apo stadin e ankesës. Në këto raste Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka ofruar të dhëna të pjesshme dhe të paqarta.

KGJK gjatë periudhës 1 korrik deri më 1 nëntor, ka deklaruar se ka pranuar gjithsej 29 njoftime për iniciim të procedurës, mirëpo ky numër nuk mund të verifikohet nga përgjigjet e gjykatave sepse disa prej tyre nuk kanë ofruar të dhëna.

Prej këtyre ankesave, sipas të dhënave të KGJK-së, 21 ankesa janë cilësuar si të pabazuara dhe janë refuzuar, ndërsa në dy raste KGJK, sipas detyrës zyrtare, ka pezulluar gjyqtarët nga puna.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës 1 korrik deri më 30 nëntor, ka pranuar gjithsej 4 ankesa disiplinore. Asnjë nga këto ankesa nuk është refuzuar dhe për asnjërin nga rastet nuk është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Në tri raste, ankesat janë dërguar tek Autoriteti Kompetent, ndërsa një rast është referuar te Prokurori i Shtetit.

Gjykata Supreme e Kosovës gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 1 nëntor ka pranuar gjithsej 3 ankesa, prej të cilave në 1 rast është kërkuar iniciimi i hetimeve ndërsa për 2 rastet tjera nuk është ofruar informacion për epilogun e tyre.





Gjykata e Apelit të Kosovës gjatë periudhës kohore të dhënë i ka pranuar 2 ankesa, prej të cilave njëra është refuzuar, ndërsa për tjetrën është kërkuar iniciimi i hetimeve nga KGJK.

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës në periudhën kohore 1 korrik deri më 1 shtator janë pranuar gjithsej 9 ankesa, prej të cilave 4 janë refuzuar ndërsa në 5 raste ankesat janë ende ta pavendosura edhe pse në të gjitha këto raste është tejkaluar afati për trajtimin e tyre prej 30 ditësh.

Gjykata Themelore e Prizrenit gjatë periudhës që është bërë monitorimi, ka pranuar gjithsej 9 ankesa, prej të cilave 6 janë refuzuar, ndërsa në dy raste tjera është iniciuar kërkesa për fillim të hetimeve.

Gjykata Themelore e Pejës, në periudhën 1 korrik deri më 1 nëntor, ka pranuar gjithsej 5 ankesa disiplinore prej të cilave në dy raste ankesat janë refuzuar si të pabazuara, një rast është kërkuar pezullimi i gjyqtarit, ndërsa për dy rastet tjera nuk janë ofruar të dhëna se si kanë përfunduar.

Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë periudhës 1 korrik deri më 1 nëntor ka pranuar vetëm një rast të ankesës disiplinore dhe ky rast është refuzuar.

Gjykata Themelore në Gjakovë gjatë periudhës që është objekt trajtimi ka pranuar vetëm një rast të ankesës disiplinore dhe ky rast është tërhequr nga vetë parashtruesi.

Gjykata Themelore e Mitrovicës në periudhën 1 korrik deri më 1 nëntor, nuk ka pranuar asnjë rast të ankesave disiplinore.


Gjykata Themelore në Gjilan ka ofruar të dhëna pas konferencës së organizuar nga BIRN dhe FOL të mbajtur më 12 dhjetor 2019, ku është prezantuar broshura me gjetjet fillestare në lidhje me rastet disiplinore në gjykatat e Kosovës.

Sipas të dhënave të ofruara nga kjo gjykatë, në periudhën korrik-nëntor 2019, janë pranuar gjithsej 4 ankesa dhe të gjitha këto janë refuzuar.

Përmes këtij raporti pasqyrohet nevoja për përmirësime të menjëhershme duke filluar nga:

- Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve ka lënë pa adresë palët që duan të ankohen ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- Respektimi i afateve në trajtimin e rasteve disiplinore duke filluar nga Autoriteti Kompetent dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Përmirësimi i ruajtjes së regjistrave për rastet disiplinore dhe rritja e transparencës në lidhje me trajtimin e këtyre rasteve;
- KGJK duhet të shtojë maksimalisht kujdesin që të mos përsëriten rastet ku cenohet parimi i fshehtësisë së procedurës, duke mos zbuluar identitetin e gjyqtarëve që janë subjekt i procedurës disiplinore qysh në fazën e formimit të panelit hetimor;
- KGJK me urgjencë duhet të rrisë transparencën dhe të ndikojë te gjykatat e Kosovës që të veprojnë njëjtë dhe të ofrojnë të dhëna cilësore dhe të plota statistikore në lidhje me efikasitetin e trajtimit të rasteve disiplinore. Një arritje e tillë, jo vetëm që kontribuon për të hapur tutje KGJK-në ndaj opinionit publik dhe rritur besimin e tyre ndaj punës së kësaj të fundit, por këtë proces e mban të hapur edhe ndaj monitoruesve të sistemit të drejtësisë për të vlerësuar punën e KGJK-së dhe Autoritetit Kompetent në trajtimin e rasteve disiplinore.





Hyrje

Ky raport ka për qëllim të vlerësojë efikasitetin dhe transparencën në procedurën e trajtimit të rasteve disiplinore të iniciuara ndaj gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në Republikën e Kosovës përgjatë periudhës 1 korrik deri më 1 nëntor 2019. Kjo periudhë është relativisht e shkurtër për të monitoruar këtë proces, andaj monitorimi do të vazhdojë deri në qershor të vitit 2020.

Përmes këtij raporti synohet të pasqyrohet numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar nga Autoriteti Kompetent, numri i rasteve të refuzuara dhe të hedhura, numri i rasteve të referuara në Prokurorinë e Shtetit dhe numri i rasteve për të cilat është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Monitorimi në të ardhmen gjithashtu do të përfshijë edhe shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve disiplinore të KGJK-së nga Gjykata Supreme.

Po ashtu, në këtë raport, për periudhën e lartpërmendur kohore, do të pasqyrohet edhe vendimmarrja e Këshillit Gjyqësor dhe puna e paneleve hetimore të formuara nga ky Këshill në lidhje me trajtimin e ankesave të rasteve disiplinore, e po ashtu do të pasqyrohet edhe puna e Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me ankesat disiplinore.

Në këtë kompozicion do të pasqyrohet efikasiteti i procedurës dhe trajtimit të rasteve disiplinore nga Autoriteti Kompetent dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në veçanti duke pasqyruar aspektin kohor dhe procedural të trajtimit të ankesave disiplinore, duke vënë kështu në pah mangësitë dhe zbrazëtitë, fillimisht në raport me Ligjin 06/L- 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve¹, si dhe mangësitë dhe zvarritjet e Autoritetit Kompetent dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës në trajtimin e rasteve disiplinore. Poashtu ky raport pasqyron edhe lëshimet e bëra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në trajtimin e rasteve disiplinore.

Raporti do të trajtojë vetëm aspektin statistikor dhe kohor të rasteve disiplinore duke respektuar në tërësi konfidencialitetin e procedurës dhe duke mos u marrë fare me identitetin e personave të përfshirë apo me përmbajtjen e veprimeve hetimore të ndërmarra.

¹ Kuvendi i Kosovës, (2018). Ligji Nr.06/L-057, Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Retrieved from: http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr06L-057_5VbMuFW4aw.pdf





Metodologjia e realizimit të monitorimit

Ky raport është realizuar përmes metodës së grumbullimit të të dhënave kuantitative si numri i ankesave të pranuar, numri i ankesave të refuzuara, numri i ankesave të hedhura dhe numri i ankesave për të cilat është kërkuar iniciimi i hetimit nga KGJK. Këto të dhëna janë marrë nga Autoriteti Kompetent - kryetarët e gjykatave, Këshilli Gjyqësor dhe Institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me të dhënat statistikore për rastet disiplinore.

Për qëllime të këtij raporti, është përdorur metoda analitike për trajtimin e të dhënave me qëllim të vlerësimit nëse Autoriteti Kompetent, Këshilli Gjyqësor dhe Institucioni i Avokatit të Popullit kanë vepruar në përputhje me përcaktimet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Procedurën Disiplinore.

Po ashtu, për qëllime të këtij monitorimi, është përdorur edhe metoda statistikore dhe krahasimore për të vlerësuar dhe matur efikasitetin e Autoriteti Kompetent dhe Këshillit Gjyqësor në trajtimin e rasteve disiplinore.

E vlerësojmë se duhet të përmendim në këtë rast bashkëpunimin e mirë dhe korrektësinë e gjykatave themelore të Kosovës, Gjykatën e Apelit si dhe Institucionin e Avokatit të Popullit për mundësimin e qasjes në të dhëna.

BIRN dhe FOL më datë 12 dhjetor 2019 kanë organizuar konferencën ku kanë prezantuar gjetjet preliminare në lidhje ankesat disiplinore dhe pastaj të njëjtat i janë dërguar gjykatave për komente eventuale të cilat janë përfshirë në raportin përfundimtar.

Të dhëna të përgjithshme tabelore për rastet disiplinore

	Gjykata Supreme	Gjykata e Apelit	Gjykata Themelore në Prishtinë	Gjykata Themelore në Mitrovicë	Gjykata Themelore në Pejë	Gjykata Themelore në Prizren	Gjykata Themelore në Ferizaj	Gjykata Themelore në Gjilan	Gjykata Themelore në Gjakovë
Ankesa të pranuar	3	2	9	0	5 ²	8 ³	1	4	1 ⁴
Numri i rasteve ku është kërkuar fillimi i hetimeve	1	1	2 ⁵	0	2	2	0	0	0
Rastet e refuzuara	2	1	5	0	4	4	1	4	0
Rastet e hedhura	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 1: Të dhënat e përgjithshme për gjykatat e Kosovës në periudhën 1 korrik deri më 1 nëntor 2019.


²Në një rast është kërkuar sipas detyrës zyrtare fillimi i hetimeve.

³Gjykata në Prizren nuk kanë dhënë informacion se çfarë ka ndodhur me 2 ankesa disiplinore të pranuar.

⁴Është tërhequr ankesa nga vetë ankuesi.

⁵Nga Gjykata Themelore e Prishtinës bëhet e ditur se këto dy raste janë në procedurë për t'i parashtruar në Këshill për iniciimin e procedurës disiplinore.





Numri i njoftimeve
për pranim të ankesave
nga Autoriteti Kompetent

29

Ankesa që kanë
rezultuar me shkelje
disiplinore

3

Rastet e
refuzuara


21

Numri i paneleve
hetimore të formuara

2

Tabela 2: Të dhënat e përgjithshme nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës
për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019





Shqyrtim individual i rasteve sipas gjykatave

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Numri i njoftimeve për pranimit të ankesave nga Autoriteti Kompetent

29

Gjatë periudhës së monitorimit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është deklaruar se ka pranuar 29 njoftime për pranimit të ankesave nga Autoriteti Kompetent. Sipas të dhënave të siguruar nga KGJK, 21 ankesa janë refuzuar si të pabazuara.

Ankesa që kanë rezultuar me shkelje disiplinore

3

KGJK gjatë procedurës hetimore, në bazë të ligjit dhe pas njoftimit nga prokuroria për shkak të dyshimeve për kryerje të veprës penale ka pezulluar nga detyra dy gjyqtarë.

Rastet e refuzuara

21

Kërkesë për pezullim ka pasur edhe nga Autoriteti Kompetent mirëpo KGJK nuk ka dhënë informacion sesa kërkesa kanë qenë apo si është procedura me ato kërkesa.

Numri i paneleve hetimore të formuara

2

KGJK ka refuzuar qasjen për BIRN dhe FOL përkundër memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar mes KGJK, BIRN dhe FOL,⁶ i cili ka paraparë mundësinë në qasje në të dhëna statistikore rreth rasteve disiplinore. Më saktësisht, KGJK nuk ka ofruar të dhëna në lidhje me numrin e kërkesave të pranuar nga

Autoriteti Kompetent për iniciimin e procedurave disiplinore, për mënyrën dhe afatet e trajtimit të këtyre kërkesave, për formimin e paneleve hetimore, kohën e themelimit të paneleve hetimore, veprimet dhe datat e ndërmarrjes së veprimeve hetimore, numrin e seancave të mbajtura, kohën brenda të cilës janë formuar panelet, dhe të dhënat tjera të kërkuara. Të dhënat e vetme të ofruara nga KGJK janë të përgjithshme, jo të plota dhe të paqarta, të cilat nuk mund të përdoren për të matur efikasitetin e paneleve hetimore për trajtimin e këtyre rasteve, si dhe aspektin kohor të përcaktuar sipas ligjit për trajtimin e tyre.

Gjykata Supreme

24 gjyqtarë

Numri i ankesave disiplinore të pranuar

3

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjithsej 24 gjyqtarë ndërsa gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 1 nëntor ka pranuar gjithsej 3 ankesa disiplinore, prej të cilave në një rast është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore në KGJK, ndërsa në dy rastet tjera nga përgjigjet e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është përshkruar decidivisht se çfarë ka ndodhur me rastet, mirëpo mund të konkludohet që janë refuzuar. Kjo e fundit duke u nisur nga fakti që nuk është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore nga KGJK dhe rastet nuk janë referuar në Prokurorinë e Shtetit.

Kërkesa për iniciim të procedurës hetimore nga KGJK

1


Nuk është dhënë informacion si kanë përfunduar

2

Në rastin e parë, ankesa është pranuar më 8 korrik 2019 ndërsa Këshilli është njoftuar më 9 korrik 2019, pra një ditë më pas.

⁶Këshilli Gjyqësor i Kosovës, BIRN Kosovo, Lëvizja FOL (2019). Memorandum i Mirëkuptimit. Retrieved from https://www.gjyqesori-rks.org/wpcontent/uploads/lgs/70901_Memorandum_Mirkuptimi_KGJK_BIRN_Levizja_FOL.pdf





Në rastin e ankesës së dytë, ankesa është pranuar më 19 korrik 2019, ditë e premte, ndërsa më 22 korrik 2019, ditë e hënë, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Këshillin për pranimin e ankesës.

Rasti i tretë i ankesës disiplinore i pranuar në Gjykatën Supreme të Kosovës, është pranuar më 14 tetor 2019, ndërsa 1 ditë më vonë më 15 tetor 2019 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës. 11 ditë pas pranimit të ankesës disiplinore, Autoriteti Kompetent ka kërkuar iniciimin e procedurës për hetim disiplinor.

Nga të dhënat e lartpërmendura, mund të konstatohet se Autoriteti Kompetent, Kryetari i Gjykatës Supreme, i ka trajtuar rastet disiplinore në përputhje me afatin fillestar prej 30 ditësh sipas përcaktimit të vendosur në Ligjin dhe Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.⁷

Gjykata e Apelit

50 gjyqtarë

Numri i ankesave
disiplinore të pranuar

2

Gjykata e Apelit të Kosovës ka gjithsej 50 gjyqtarë ndërsa në periudhën kohore 1 korrik deri më 1 nëntor ka pranuar dy ankesa, ku njëra është refuzuar ndërsa në rastin tjetër është kërkuar iniciimi i procedurës disiplinore nga KGjK. Njëra nga ankesat është e iniciuar nga KGjK dhe një ankesë është paraqitur nga personi fizik.

Kërkesa për iniciim
të procedurës
disiplinore nga KGjK

1

Ankesa e parë është pranuar më 4 shtator 2019, ndërsa më 30 shtator 2019 është iniciuar procedura nga Autoriteti Kompetent, Kryetari i Gjykatës së Apelit, i cili ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që ta iniciojë procedurën hetimore.

Është
refuzuar

1

Në lidhje me këtë rast, Autoriteti Kompetent, Gjykata e Apelit, nuk ka dhënë informacion lidhur me epilogun e këtij rasti në Këshill.

Tabela 5:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës së Apelit
për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019

Ankesa e dytë është pranuar më 24 shtator 2019, e njëjta është refuzuar më 21 tetor 2019 si e pabazuar, ndërsa më 25 tetor 2019 me aktvendimin e Autoritetit Kompetent është njoftuar pala që ka paraqitur ankesën, gjyqtari dhe Këshilli Gjyqësor.

Në rastin e dytë, Gjykata e Apelit, nuk ka dhënë informacion se kur ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës, ndërsa ankesa është trajtuar brenda afatit ligjor prej 1 muaji.

Paragrafi 4 i nenit 7 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve përcakton se “Lidhur me vendimin e marrë Autoriteti Kompetent e njofton menjëherë me shkrim palën e cila ka paraqitur ankesën, gjyqtarin ndaj të cilit është paraqitur ankesa, Këshillin dhe Avokatin e Popullit në rastet e parapara me ligj”.

Në këtë rast, shihet se kanë kaluar 4 ditë nga koha kur është refuzuar ankesa ndërsa nuk është dhënë informacion fare në lidhje me datën se kur është njoftuar Institucioni i Avokatit të Popullit.

⁷Kuvendi i Kosovës, (2018). Ligji Nr.06/L-057, Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Retrieved from: http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr06L-057_5VbMuFW4aw.pdf





Gjykata Themelore në Prishtinë

87 gjyqtarë




Tabela 6:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Prishtinës për periudhën 1 korrik - 1 shtator 2019

Gjykata Themelore e Prishtinës ka gjithsej 87 gjyqtarë ndërsa në periudhën kohore 1 korrik deri më 1 shtator 2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë janë pranuar gjithsej 9 ankesa disiplinore. Prej këtyre ankesave, 4 janë refuzuar, 2 janë në procedurë të inicimit të rastit në KGJK, 2 ankesa janë në fazën e grumbullimit të informacionit dhe 1 ankesë është në fazën e inicimit të rastit në Prokurori.

Në rastet e paraqitura në Gjykatën Themelore të Prishtinës, shihet se nuk është respektuar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesave disiplinore dhe gjithashtu ka vonesa të qarta në njoftimin e KGJK-së dhe IAP-së në lidhje me pranimin e ankesave disiplinore.

Përkundër asaj që BIRN ka kërkuar të dhëna edhe për periudhën 1 shtator deri më 1 nëntor 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës ka kthyer përgjigje vetëm në lidhje me periudhën e parë kohore.

Nga 9 ankesat e pranuar në periudhën 1 korrik deri më 1 shtator 2019, janë në procedim dy raste për të parashtruar kërkesë për fillim të hetimit disiplinor në KGJK.

Ankesa e parë është pranuar më 2 korrik 2019 dhe më 12 korrik 2019 është njoftuar KGJK dhe IAP në lidhje me pranimin e ankesës.

Në lidhje me këtë rast, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim më 20 shtator 2019 dhe po të njëjtën ditë vendimi u është dërguar palëve.

Në këtë rast, Autoriteti Kompetent nuk ka njoftuar në lidhje me llojin e aktvendimit të nxjerrë mirëpo nga fakti që nuk është kërkuar inicimi i procedurës disiplinore nga KGJK apo çështja nuk është referuar te Prokurori i Shtetit, nënkupton se ky rast është hedhur apo refuzuar.

Po në këtë rast, shihet se ankesa është pranuar më 2 korrik 2019 dhe është vendosur më 20 shtator 2019, pra është tejkaluar afati 30 ditor për shqyrtimin e ankesës dhe vendosjen lidhur me të.

Po ashtu, nga momenti i pranimit të ankesës nga Autoriteti Kompetent e deri te njoftimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë kaluar gjithsej 10 ditë, përkundër që paragrafi 2 i nenit 4 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve parasheh që *“Ankesa pranohet nga Autoriteti Kompetent apo nga zyrtari i autorizuar nga ky Autoritet. Autoriteti Kompetent e njofton Këshillin me shkrim lidhur me pranimin e ankesës menjëherë”*.⁸


Ankesa e dytë është pranuar nga Autoriteti Kompetent më 3 korrik 2019 ndërsa më 12 korrik 2019 është njoftuar KGJK dhe IAP në lidhje me pranimin e ankesës.

Kjo ankesë deri më 20 nëntor 2019 ende është në procedim të dërgimit të kërkesës për inicim të hetimit disiplinor në KGJK.

Njëjtë sikurse në rastin paraprak, shihet se nuk është respektuar afati për njoftimin e Këshillit Gjyqësor të

⁸ Ibid.





Ankesa e katërt është pranuar më 15 korrik 2019 ndërsa më 7 gusht 2019 është njoftuar KGJK dhe IAP për pranimin e ankesës.

Autoriteti Kompetent më 12 nëntor ka marrë aktvendim në lidhje me këtë rast mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me llojin e aktvendimit mirëpo duke qenë që nuk është kërkuar nisja e hetimit nga KGJK apo rasti nuk është dërguar te Prokuroria e Shtetit, mund të konsiderohet që rasti është refuzuar apo hedhur.

Qartazi shihet se edhe në këtë rast është tejkaluar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesës nga Autoriteti Kompetent siç parashihet me paragrafin 1 të nenit 6 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Lidhur me Ankesën e 3-të dhe të 4-të ka mospërputhje sa i përket numrit që kanë marrë Ankesat. Kështu, Ankesa e pranuar më 15 korrik 2019 është regjistruar me numër rendor AD/GJTHP/21/19. Ndërsa Ankesa e pranuar më 19 korrik 2019 është regjistruar me numër rendor AD/GJTHP/20/19. Pra përkundër faktit se Ankesa me numër rendor 20/19 është pranuar 4 ditë pas ankesës me numër rendor 21/19, është regjistruar para ankesës e cila ka arritur më herët.

Ankesa e pestë është pranuar më datë 24 korrik 2019, ndërsa Autoriteti Kompetent më 7 gusht 2019 ka njoftuar KGJK-në dhe IAP për pranimin e Ankesës. Përkundër faktit se kanë kaluar 119 ditë, kjo ankesë është në procedim të dërgimit në KGJK.

Gjithashtu, në lidhje me këtë ankesë është shkelur edhe afati për njoftimin e KGJK nga Autoriteti Kompetent në lidhje me pranimin e ankesës.

Ankesa e gjashtë është pranuar më 9 gusht 2019, ndërsa Autoriteti Kompetent nuk ka dhënë informacion se kur e ka njoftuar KGJK në lidhje me pranimin e ankesës.

Në lidhje me këtë ankesë është nxjerrë vendim më 17 tetor 2019, pa dhënë sqarim se çfarë lloji i vendimit është nxjerrë.

Sikurse në rastet paraprake, pasi që nuk ka të dhëna që rasti është referuar te Prokuroria e Shtetit apo është kërkuar inicimi i procedurës disiplinore nga Këshilli Gjyqësor, konsiderohet se kjo lëndë është hedhur apo refuzuar, ndërsa edhe në këtë rast shihet se nuk është përcaktuar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesës.


Ankesa e shtatë është pranuar më 15 gusht 2019 dhe kjo ankesë është ende në procedim për t'u dorëzuar në Prokurori për shkak të dyshimit se ka vepër penale.

Edhe pse Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Rregullorja për Procedurën Disiplinore nuk përcaktojnë afat të qartë në lidhje me kohën brenda së cilës Autoriteti Kompetent duhet ta referojë çështjen te Prokurori i Shtetit, periodha gati 3 muajve mund të konsiderohet vonesë në trajtimin e kësaj ankesë.

Ankesa e tetë është pranuar nga Autoriteti Kompetent më 27 gusht 2019 dhe po të njëjtën ditë është njoftuar KGJK dhe IAP në lidhje me pranimin e ankesës ndërsa më 28 tetor 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim për këtë ankesë pa dhënë detaje në lidhje me llojin e aktvendimit, por pa e referuar te KGJK apo te Prokurori i Shtetit.

Sikurse në rastet paraprake shihet qartazi se nuk është respektuar dhe është tejkaluar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesës.





Ankesa e shtatë është pranuar më 15 gusht 2019 dhe kjo ankesë është ende në procedim për t'u dorëzuar në Prokurori për shkak të dyshimit se ka vepër penale.

Edhe pse Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Rregullorja për Procedurën Disiplinore nuk përcaktojnë afat të qartë në lidhje me kohën brenda së cilës Autoriteti Kompetent duhet ta referojë çështjen te Prokurori i Shtetit, periudha gati 3 muajve mund të konsiderohet vonesë në trajtimin e kësaj ankesë.

Ankesa e tetë është pranuar nga Autoriteti Kompetent më 27 gusht 2019 dhe po të njëjtën ditë është njoftuar KGJK dhe IAP në lidhje me pranimin e ankesës ndërsa më 28 tetor 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim për këtë ankesë pa dhënë detaje në lidhje me llojin e aktvendimit, por pa e referuar te KGJK apo te Prokurori i Shtetit.

Sikurse në rastet paraprake shihet qartazi se nuk është respektuar dhe është tejkaluar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesës.


Ankesa e nëntë është e pranuar më datë 29 gusht 2019 ndërsa një ditë më vonë, më 30 gusht është njoftuar KGJK dhe IAP në lidhje me pranimin e ankesës dhe janë akoma në fazën e grumbullimit të informacioneve.

Edhe te ky rast shihet se nuk është respektuar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesës nga Autoriteti Kompetent.


Si përfundim, nga rastet e paraqitura në Gjykatën Themelore të Prishtinës shihet se nuk është respektuar afati 30 ditor për shqyrtimin fillestar të ankesave disiplinore dhe gjithashtu ka vonesa të qarta në njoftimin e KGJK-së dhe IAP-së në lidhje me pranimin e ankesave disiplinore.

Gjykata Themelore e Prishtinës nuk ka ofruar të dhëna në lidhje me aktvendimet e nxjerra në ankesat disiplinore duke lënë të nënkuptohet lloji i aktvendimit vetëm nga kërkesa eventuale në KGJK për iniciimin e procedurës disiplinore apo referimi i çështjes te Prokurori i Shtetit.





Gjykata Themelore në Mitrovicë




BIRN ka kërkuar të dhëna në lidhje me rastet disiplinore dhe procedimin e tyre në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për periudhën kohore 1 korrik deri më 1 nëntor 2019, dhe ka pranuar përgjigje sipas së cilës nuk është ngritur asnjë proces disiplinor kundër gjyqtarëve të kësaj gjykate. Ndërsa, kryetari i Gjykatës na është përgjigjur se gjatë periudhës në fjalë ka pranuar 3 njoftime kundër punës së dy gjyqtarëve por për nga natyra e tyre nuk janë përfshirë në përgjegjësinë disiplinore.

Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, z. Nikola Kabashiq, nuk ka dhënë informacion në bazë të së cilit mund të kuptohet se si në fakt janë trajtuar këto njoftime, nëse janë trajtuar si ankesa konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve apo jo.

*Tabela 7:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Mitrovicës për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019*

Gjykata Themelore në Pejë



Gjykata Themelore e Pejës ka gjithsej 28 gjyqtarë ndërsa për periudhën 1 korrik deri më 1 nëntor ka pranuar gjithsej 5 ankesa, prej të cilave 2 janë refuzuar, në 2 nuk është ofruar informacion se çka ka ndodhur ndërsa në 1 rast është kërkuar pezullim i gjyqtarit sipas detyrës zyrtare.


Ankesa e parë është e pranuar më 26 korrik 2019. Për këtë ankesë Gjykata Themelore e Pejës është njoftuar nga KGJK sepse ankesa është dorëzuar në KGJK.

Autoriteti Kompetent nuk ka dhënë informacione se çfarë vendimi është nxjerrë në lidhje me këtë ankesë, si është proceduar kjo ankesë më tutje apo datat në lidhje me veprimet e ndërmarra.

Ankesa e dytë është pranuar më 6 gusht 2019. Në lidhje me këtë ankesë KGJK është njoftuar të njëjtën ditë ndërsa nuk ka të dhëna se a është njoftuar IAP.

*Tabela 8:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Pejës për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019*





Ankesa e tretë është e pranuar më 2 shtator 2019 ndërsa më 6 shtator 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim dhe ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

Autoriteti Kompetent pretendon se ka njoftuar palët, gjyqtarin, KGJK-në, mirëpo nuk kanë dhënë informacion se kur është kryer ky njoftim për ankesat individualisht.

Ankesa e katërt është pranuar më 9 shator 2019 dhe po të njëjtën ditë, Autoriteti Kompetent ka marrë vendim për refuzimin e ankesës.

Në rastin e pestë, më 20 shator 2019, Autoriteti Kompetent sipas detyrës zyrtare ka paraqitur kërkesë për fillim të hetimit dhe kërkesë për pezullimin e gjyqtarit, pa dhënë informacione shtesë në lidhje me epilogun e këtij rasti.

Gjykata Themelore në Prizren






Tabela 9:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Prizrenit
për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019

Ankesa e dytë është pranuar më 28 gusht 2019. Në lidhje me këtë rast, subjekti i ankesës më 3 shtator ka dhënë deklaratën rreth ankesës. Në lidhje me këtë ankesë, më 5 shator 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim me të cilin ankesa është refuzuar si e pabazuar, dhe po të njëjtën datë është njoftuar pala, gjyqtari dhe KGJK-ja.

Ankesa tretë është pranuar më 28 gusht 2019. Në lidhje me këtë rast, subjekti i ankesës më 2 shtator ka dhënë deklaratë. Në lidhje me këtë ankesë, më 5 shator 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim me të cilin ankesa është refuzuar si e pabazuar, dhe po të njëjtën datë është njoftuar pala, gjyqtari dhe KGJK-ja.

Në asnjë nga këto raste, Autoriteti Kompetent nuk ka kërkuar fillimin e hetimeve nga KGJK, asnjëri nga rastet nuk është referuar te Prokuroria e Shtetit ndërsa të tri ankesat janë refuzuar si të pabazuara.





Në lidhje me 5 ankesat e tjera, Autoriteti Kompetent nuk ofruar të dhëna në lidhje me datat e pranimit të ankesave mirëpo ka ofruar informacione për aktvendimet që ka nxjerrë Autoriteti Kompetent dhe datat e nxjerrjes së këtyre aktvendimeve.

Lidhur me ankesën e parë të periudhës 1 shator deri më 1 nëntor, aktvendimi nga Autoriteti Kompetent është nxjerrë më 28 tetor 2019 dhe po të njëjtën ditë është njoftuar KGJK dhe IAP, (Institucioni që e ka dërguar ankesën)

Lidhur me ankesën e dytë, më 14 tetor 2019, kërkesa së bashku me lëndën i është dërguar KGJK-së për iniciimin e procedurës, pa dhënë asnjë informacion shtesë në lidhje me epilogun e këtij rasti. Lidhur me ankesën e tretë, Autoriteti Kompetent ka dhënë përgjigje se nga ZPD është pranuar një kërkesë por pa sqaruar datën se kur është pranuar kjo kërkesë ndërsa Autoriteti Kompetent më 7 tetor 2019 ka kërkuar deklaratë nga subjekti i ankesës dhe më 12 tetor 2019, subjekti i ankesës ka dhënë deklaratën e tij, ndërsa lënda më 14 tetor 2019 i është dërguar KGJK-së me kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore.

Lidhur me ankesën e katërt, më 30 shtator 2019 parashtruesi i kërkesës është njoftuar se për kërkesën e tij është vendosur në qershor të vitit 2019 dhe në lidhje me këtë vendim më 20 shtator 2019 është njoftuar parashtruesi i ankesës dhe KGJK.


Në lidhje me këtë rast, shihet se Autoriteti Kompetent nuk ka ofruar informacion të plotë dhe të saktë sepse data kur është njoftuar parashtruesi i kërkesës është para datës kur është vendosur në lidhje me ankesën.

Ankesa e pestë është pranuar më 13 shator 2019 përmes KGJK-së ndërsa më 27 shator 2019, subjekti i ankesës ka dhënë deklaratë, ndërsa aktvendimi për çështjen është nxjerrë më 30 shtator 2019 dhe po të njëjtën ditë janë njoftuar KGJK dhe parashtruesi i ankesës.

Pra, me përjashtim të ankesës së 5 të periudhës së dytë kohore, Autoriteti Kompetent nuk ka ofruar të dhënat bazike në lidhje me rastet disiplinore të pranuar, po ashtu mungojnë të dhënat në lidhje me llojin e aktvendimeve të nxjerra dhe gjithashtu mundon epilogu përfundimtar në lidhje me rastin.

Kësisoj, është pothuajse e pamundur objektivisht për të vlerësuar nëse në këtë periudhë kohore janë respektuar afatet e përcaktuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregulloren për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve.





Gjykata Themelore në Feriza

31 gjyqtarë

Numri i ankesave disiplinore të pranuara	1	Gjykata Themelore në Ferizaj ka gjithsej 31 gjyqtarë ndërsa në periudhën kohore 1 korrik deri më 1 nëntor 2019, ka pranuar 1 rast të ankesës disiplinore dhe ky rast është refuzuar.
Inicim i procedurës disiplinore në KGJK	0	Gjatë periudhës për të cilin është realizuar monitorimi, ka vetëm një rast disiplinor. Kjo ankesë është pranuar më 5 gusht 2019 nga Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili përmes shkresës zyrtare e ka deleguar në kompetencë të Gjykatës Themelore në Ferizaj ankesën me pretendimet për shkelje disiplinore.
Është refuzuar	1	Në lidhje me këtë ankesë më 22 gusht 2019 Autoriteti Kompetent ka njoftuar KGJK për pranimin e saj, ndërsa më 23 gusht 2019 është pranuar deklarata me shkrim nga gjyqtari.
Nuk është ofruar informacion	0	Kjo ankesë është refuzuar me datë 28 gusht 2019.

Tabela 10:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Ferizajt për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019

Në këtë rast për të cilin janë ofruar informacione të pjesshme, shihet se nuk është respektuar obligimi për njoftim të menjëhershëm të KGJK-së pas pranimit të ankesës, ndërsa gjithashtu nuk janë ofruar të dhëna në lidhje me mënyrën e vendosjes së rastit.

Gjykata Themelore në Gjilan

29 gjyqtarë

Numri i ankesave disiplinore të pranuara	4	Më 12 dhjetor 2019, BIRN dhe FOL me mbështetjen e USAID/JSSP organizuan konferencën “Rritja e Transparencës së Gjyqësorit” ku u prezantuan të dhënat fillestare rreth monitorimit të ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Gjatë konferencës, kryetari i Gjykatës Themelore të Gjilanit, z. Ramiz Azizi, u zotua se do t'i dërgojë të dhënat në lidhje me rastet disiplinore.
Inicim i procedurës disiplinore në KGJK	0	Rrjedhimisht, më 30 dhjetor 2019, BIRN ka pranuar të dhënat e Gjykatës së Gjilanit. Sipas këtyre të dhënave rezulton se Gjykata Themelore në Gjilan për periudhën korrik - nëntor 2019 ka pranuar gjithsej 4 ankesa disiplinore ndërsa kjo gjykatë në tërësi ka 29 gjyqtarë. Të gjitha ankesat janë refuzuar.
Është refuzuar	4	Për të gjitha këto raste, Gjykata në Gjilan ka ofruar të dhëna për datën e refuzimit dhe datën e njoftimit të palëve mirëpo nuk është ofruar informacion se kur janë pranuar ankesat.
Nuk është ofruar informacion	0	

Tabela 10:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Gjilanit për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019





Ankesa e parë është refuzuar më 1 korrik 2019; ankesa e dytë është refuzuar më 20 shtator 2019; ankesa e tretë është refuzuar më 29 tetor 2019; ankesa e katërt është refuzuar më 31 tetor 2019. Për të gjitha ankesat e përmenduar më lartë palët janë njoftuar po atë ditë kur është bërë refuzimi.


Gjykata Themelore në Gjakovë

20 gjyqtarë


Numri i ankesave disiplinore të pranuar	1	Gjykata Themelore në Gjakovë ka gjithsej 28 gjyqtarë ndërsa në periudhën e trajtuar në monitorim ka pranuar vetëm një ankesë disiplinore.
Në procedurë për inicim të procedurës disiplinore nga KGJK	0	Në këtë rast parashtues i ankesës ishte një avokat i cili ka parashtuar ankesë më 8 gusht 2019 e cila është pranuar në KGJK më 14 gusht 2019 ndërsa një ditë më pas është njoftuar Gjykata Themelore në Gjakovë.
Është refuzuar	1	Në lidhje me këtë ankesë më 21 gusht, vetë paraqitësi i ankesës është tërhequr nga ankesa e parashtuar ndërsa më 23 gusht 2019, Autoriteti Kompetent ka nxjerrë aktvendim në lidhje me ankesën e tërhequr.
Në fazën e grumbullimit të informacionit	0	

Tabela 10:
Të dhënat për rastet disiplinore të Gjykatës Themelore të Gjakovës
për periudhën 1 korrik - 1 nëntor 2019





Institucioni i Avokatit të Popullit



1 korrik - 1 shtator 2019

Tabela 13: Të dhënat e përgjithshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit për periudhën 1 korrik - 1 shtator 2019



1 shtator - 1 nëntor 2019

Tabela 13: Të dhënat e përgjithshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit për periudhën 1 shtator - 1 nëntor 2019

IAP në periudhën kohore 1 Korrik – 1 Shtator 2019 ka pranuar 2 ankesa në lidhje me gjyqtarët


Asnjë nga këto 2 ankesa nuk është hedhur dhe asnjë nga këto ankesa nuk është dërguar në KGJK. Njëri rast i është referuar Prokurorisë së Shtetit.

Ankesa 1 – e pranuar më 24 korrik 2019 ndërsa më 31 korrik 2019, IAP e ka dërguar ankesën tek Autoriteti Kompetent në Gjykatën Themelore në Ferizaj. Më 28 gusht 2019, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga kjo gjykatë.

Ankesa 2 – e pranuar më 16 gusht 2019 ndërsa më 20 gusht 2019, IAP e ka dërguar ankesën tek Autoriteti Kompetent. IAP më 20 gusht 2019 i ka drejtuar shkresën Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Më 19 shtator 2019, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Sipas këtyre të dhënave, vërejmë që IAP është njoftuar brenda afatit ligjor (30 ditë) nga Autoriteti Kompetent për të dy ankesat e pranuar.





IAP në periudhën kohore 1 Shtator 2019 – 1 Nëntor 2019 ka pranuar 2 Ankesa


Asnjë ankesë nuk është hedhur ndërsa ankesat janë paraqitur nga persona fizikë. Asnjëri nga rastet nuk është dërguar në KGJK dhe po ashtu nuk është referuar Prokurorisë së Shtetit.

Ankesa 1 – e pranuar më 9 shtator 2019, ndërsa më 12 shtator 2019, IAP e ka dërguar ankesën te Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Më 23 shtator 2019, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga kjo gjykatë,

Ankesa 2 – e pranuar më 30 shtator 2019 ndërsa më 2 tetor 2019, IAP e ka dërguar ankesën te Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren. Më 29 tetor Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga kjo gjykatë,

IAP është njoftuar brenda afatit ligjor (30 ditë) nga Autoriteti Kompetent për të dy ankesat e pranuar.





Ligji i ri për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve

Mangësitë e Ligjit

Ligji 06/L- 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 26 dhjetor 2018 ndërsa 15 ditë më pas ka hyrë në fuqi.

Përmes këtij ligji synohej krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës. Njëkohësisht synohej eliminimi i mangësive të evidentuara në trajtimin e çështjeve disiplinore ndaj gjyqtarëve në Republikën e Kosovës.

Po ashtu, përmes këtij ligji përcaktohen veprimet që përbëjnë shkelje disiplinore si dhe përcaktohen procedurat standarde dhe parimet themelore për zhvillimin e hetimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Ky ligj rregullon nisjen e rastit disiplinor, afatet për ndërmarrjen e veprimeve disiplinore, parashkrimin e shkeljeve disiplinore, kriteret për hapjen e hetimeve, kriteret për mbylljen e hetimeve, themelimin e paneleve hetimore, punën e tyre, vendimmarrjen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës në lidhje me rastet disiplinore dhe mjetet juridike në dispozicion për t'u ushtruar ndaj vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ky ligj i ri përbën një reformë të thellë dhe esenciale në procesin e disiplinimit të gjyqtarëve për dallim nga procedura pararendëse që i jepte rol të veçantë Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

Me ligjin e ri, rol crucial u jepet Autoriteti Kompetent që nënkupton kryetarët e gjykatave që tani shërbejnë si filtër i parë i ankesave disiplinore dhe si iniciator të kërkesave në Këshill për iniciimin e procedurave disiplinore.

Me gjithë ndryshimet pozitive që sjell ky ligj i ri, të paktën një çështje kryesore ka mbetur pa u rregulluar.

Neni 9 i Ligjit, ku përcaktohet Autoriteti Kompetent tek i cili duhet të ushtrohet ankesa ndaj një gjyqtari, ka lënë pa adresë ankesat që drejtohen ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përderisa përcaktohet se ndaj gjyqtarëve të gjykatave themelore, ankesa iniciohet te kryetari i Gjykatës Themelore, ndaj gjyqtarëve të Apelit, ankesa adresohet te kryetari i Gjykatës së Apelit, ndaj kryetarëve të gjykatave themelore dhe atij të Apelit, ankesa adresohet te Kryetari i Gjykatës Supreme, ndaj kryetarit të Gjykatës Supreme, ankesa iniciohet te Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mirëpo askund nuk përcaktohet se ku adresohet ankesa ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përderisa interpretimi logjik dhe analogjia na sjell në përfundim se sikurse te gjyqtarët e themeloreve ashtu edhe tek Apeli, ankesa iniciohet te kryetari i gjykatës, kjo nuk është përcaktuar askund shprehimisht në këtë ligj dhe kështu krijon një zbrazëti dhe identifikon një lëshim serioz te personat përgjegjës për hartimin e këtij ligji.





Shkelja e konfidencialitetit të procedurës

KGJK-ja në mbledhjen e 222 të mbajtur më 31 korrik 2019 mori vendim për formimin e një Paneli Hetimor për një gjyqtar.


Mirëpo KGJK-ja me rastin e publikimit të vendimit për themelimin e panelit hetimor në faqen e zyrtare të internetit KGJK ka publikuar edhe emrin e gjyqtarit (subjektit) për të cilin është themeluar Paneli Hetimor.

Në Link-un ku është publikuar vendimi shkruan emri i gjyqtarit (subjektit) “Vendimi Nr.179.2019. për Themelim të Panelit Hetimor rasti i Sylë Lokaj”.

Me këtë veprim KGJK-ja ka shkelur nenin 3 (Parimet e Procedurës Disiplinore ndaj gjyqtarëve), të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, respektivisht paragrafi 1 nënpar. 1.2 “Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare”, ku thuhet se “Kryetari i Gjykatës, zyrtari kompetent dhe gjyqtarët anëtarë të panelit hetimor kanë për obligim të ruajnë fshehtësinë dhe të mos ndajnë informata privatisht apo publikisht (konfidencialitetin) lidhur me procedurën disiplinore deri në momentin kur vendimi për shqiptimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit bëhet i formës së prerë.

Në rastin konkret, ndonëse është përmirësuar gabimi në faqen e KGJK-së, përsëri është i qasshëm vendimi me gabim dhe rrjedhimisht identifikohet gjyqtari që është subjekt i procedurës disiplinore. Rastet e tilla cenojnë në mënyrë të qartë Ligjin dhe Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore dhe lëndojnë tërë procesin disiplinor.






Rekomandimet

- Autoriteti Kompetent duhet t'i respektojë përcaktimet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregulloren për Përgjegjësi Disiplinore të KGJK-së, për afatin e shqyrtimit fillestar të ankesave të pranuara;
- Autoriteti Kompetent duhet t'i mbajë regjistrat fizikë dhe elektronikë me të dhëna të plota rreth ankesave dhe të dhënat statistikore t'i publikojë në ueb portalin e KGJK-së, siç është vepruar më parë nga Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Duhet të iniciohet plotësim/ndryshimi i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të korrigojen lëshimet në ligj lidhur me adresimin e ankesave;
- Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve duhet të parashikojë mundësinë e suspendimit të gjyqtarëve edhe në rastet tjera dhe jo vetëm për vepër penale;
- Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duhet të parashikojë mundësinë e suspendimit të gjyqtarëve edhe në rastet tjera përveç se për vepër penale;
- Autoriteti Kompetent duhet t'i respektojë përcaktimet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregullores së KGJK-së për Procedurën Disiplinore në lidhje me afatin brenda së cilit duhet të shqyrtohen ankesat disiplinore;
- Autoriteti Kompetent duhet t'i respektojë përcaktimet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregullores së KGJK-së për Procedurën Disiplinore në lidhje me afatin brenda të cilit Autoriteti Kompetent duhet ta njoftojë KGJK-në lidhje me pranimin e ankesave;
- Autoriteti Kompetent duhet t'i respektojë përcaktimet e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Rregullores së KGJK-së për Procedurën Disiplinore në lidhje njoftimin e IAP dhe palës parashtruese të ankesës në lidhje me vendimin e nxjerrë;
- KGJK dhe Autoriteti Kompetent duhet ta rrisin ndjeshëm kujdesin në trajtimin e rasteve disiplinore duke mos cenuar parimin e konfidencialitetit të procedurës përmes zbulimit të identitetit të subjektit të procedurës, përpara se vendimi të jetë i formës së prerë siç ka ndodhur me rastin e evidentuar në këtë raport;
- KGJK dhe Autoriteti Kompetent duhet të tregojnë dukshëm gatishmëri më të madhe për të ofruar informacione statistikore në lidhje me procedurat dhe efikasitetin e trajtimit të rasteve disiplinore;
- KGJK duhet t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm që ta çaktivizojë ueb-faqen aktuale të Zyrës së Prokurorit Disiplinor në mënyrë që të mos shkaktohet konfuzion te palët që mund të paraqesin ankesë përmes këtij institucioni tashmë të shuar.





Referencat

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, (2019).

Vendim për caktim të gjyqtarëve në panel hetimor. Retrieved from:

https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/51655_KGJK-Vendimi_Nr_179_2019_per_Themelim_te_Panelit_Hetimor_rasti_i_Syle_Lokaj.pdf

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, BIRN Kosovo, Lëvizja FOL (2019).

Memorandum i Mirëkuptimit. Retrieved from



https://www.gjyqesori-rks.org/wpcontent/uploads/lgsl/70901_Memorandum_Mirkuptimi_KGJK_BIRN_Levizja_FOL.pdf

Kuvendi i Kosovës, (2018). Ligji Nr.06/L-057,

Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Retrieved from:

http://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Ligjinr06L-057_5VbMuFW4aw.pdf







Janar, 2020

